



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 3337 Prot.

Tiranë, më 11.09. 2024

UDHËZIM

Nr. 9, datë 11.09. 2024

PËR NJË NDRYSHIM TË UDHËZIMIT NR 5, DATE 01.08.2024 "PËR
LIDHJEN E KONTRATAVE ME FARMACITË DHE AGJENCITË
FARMACEUTIKE PËR VITIN 2024"



Në zbatim të ligjit nr.10383 "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.124 datë 5.3.2014 " Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.252, datë 29.4.2022 " Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", vendimit Nr.24 datë 09.09.2024 të Këshillit Administrativ të FONDI-it "Për kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratës me FOND-in dhe procedurat për lidhjen e kontratave",

UDHËZ O J:

1. Pika 3 e kapitullit të parë ndryshon: "Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat janë të kontraktuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të Listës së Barnave të rimbursuara , aplikojnë për rilidhje të kontrates "Për rimbursimin e recetes elektronike" me Drejtorinë Rajonale të Fondit ku ushtrojnë aktivitetin.
2. Pika 4 riformulohet:Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, të cilët janë të kontraktuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të listës së barnave të rimbursuara 2024, për të rilidhur

kontratë, duhet të aplikojnë në platformën e-Albania, shërbimi **Aplikim për rilidhjen e kontratës vjetore me Agjencitë dhe Farmacitë e tregut të hapur**, duke përzgjedhur drejtorinë/degën rajonale të Fondit me të cilën do të rilidhin kontratë, të dorëzojnë nëpërmjet ngarkimit dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të LBR 2024, si më poshtë:

- a. Kopjen e Certifikatës së ushtrimit të profesionit, për drejtuesin teknik lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve.
 - b. Kopje e certificates së ushtrimit të profesionit për farmacistët e punësuar
 - c. Kontratat e punës të noterizuar për të punësuarit në Farmaci
 - d. Inventarin e barnave, të printuar nga sistemi i recetës elektronike eRx, në datën 1 Gusht 2024, para fillimit të aktivitetit.
 - e. Inventarin e barnave, të skaduara, (nëse ka), të printuar nga sistemi eRx, në datën 1 Gusht 2024, para fillimit të aktivitetit.
3. Pika 15 e kapitullit “Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, të cilat lidhin kontratë për herë të parë” riformulohet: Komisioni për miratimin e lidhjes së kontratave me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike që lidhin kontratë për herë të parë me Fondin, i ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i Fondit shqyrton dokumentacionin e ngarkuar nga subjekti në platformën e-Albania si edhe verifikon në vend:
- a. Genplanin apo Planimetrinë e Mjedisit, mbi 50 m² (15 m² Agjencia), të lëshuar nga një Arkitekt, Inxhinier i licencuar.
 - b. Plan vendosjen, të lëshuar nga një Arkitekt, Inxhinier i licencuar, ku:
 - ✓ distanca/largësia e Farmacisë/Agjencisë të jetë mbi 150 metra (rrugë këmbësore) nga Farmacitë apo Agjencitë ekzistuese me kontratë;
 - ✓ distanca/largësia e Farmacisë të jetë, mbi 20 metra nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor Publik (*nuk aplikohet për Agjencitë farmaceutike*).
- Komisioni mban proces verbal dhe ia paraqet për vendimarrje Drejtorit të Përgjithshëm.
- Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm i percillet Drejtorise Rajonale të Fondit dhe subjektit që ka aplikuar për lidhje kontrate.
4. Në kapitullin “Detyrat e Komisionit vlerësues për lidhjen e kontratave”, paragrafi “a” riformulohet:

a. Për farmacitë/agjencitë, të cilat aplikojnë për rilidhje kontrate:

- Të verifikojnë saktësinë e dokumentacionit të ngarkuar nga ana e subjektit farmaceutik për rilidhjen e kontratës.
- Të verifikojnë, formularin e Vetëdeklarimit dhe të identifikojnë nëse ka ndryshime nga kontraktimi i mëparshëm dhe nëse ka, atëherë të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit që vërteton ndryshimin.
- Të plotësojë dosjen e veçantë të krijuar për subjektin, me dokumentacionin e plotë të ngarkuar nga subjekti farmaceutik dhe dokumentacionin e siguruar nga nëpunësi i administratës.

5. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale të Fondit për zbatimin e këtij udhëzimi

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Spartak Zekja

